



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
KËSHILLI STUDENTOR INSTITUCIONAL

Nr. 2/22 Prot.

Shkodër, më 10/05/2022

VENDIM

Nr. 2, datë 10/05/2022

**"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRËNDSHME TË KËSHILLAVE
STUDENTOR TË USH-SË"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22/07/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", neni 99, dhe Urdhërit nr. 1, datë 19/04/2022 i kryetarit të Këshillit Studentor Institucional:

VENDOSI

1. Të miratojë rregulloren mbi organizimin e Këshillave Studentor, të USH-së, sipas materialit bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

ARMANDO LEKAJ



Adresa: Rektorati, Sheshi 2 Prilli, Shkodër, Shqipëri; G-mail: keshillistudentorunishk@gmail.com

RREGULLORE

“MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLAVE STUDENTOR TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

I. Dispozita të përgjithshme

Këshilli Studentor i Universitetit të Shkodrës (KSUSH) është një organizim i pavarur i studentëve. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

Neni 1

Funksionimi i Këshillit Studentor bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Neni 2

Përmbajtja

- 1- “USH” është Universiteti i Shkodrës.
- 2- “KSUSH” është Këshilli Studentor i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- 3- “KSI” është Këshilli Studentor Institucional.
- 4- “Kuorum” quhet prania e 50% + 1 e të gjithë anëtarëve të organit përkatës.

II. Organizimi i Këshillave Studentor

Neni 3


Këshilli Studentor përbëhet nga Këshilli Studentor Institucional dhe Këshillat Studentor në nivel njësie qendrore.

Neni 4

1. Këshilli Studentor Institucional është organi më i lartë vendimmarrës i Këshillit Studentor të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
2. Këshilli Studentor Institucional vepron në rang universiteti.

Neni 5

1. Këshillat Studentor në nivel njësie qendrore veprojnë në fakultetin përkatës në bashkëpunim me Këshillin Studentor Institucional.



Neni 6

Këshilli Studentor Institucional përbëhet nga kryetari, zv. kryetari, sekretari i përgjithshëm dhe anëtarët e zgjedhur.

Neni 7

Këshillat Studentor në nivel njësie qendrore përbëhen nga kryetari dhe anëtarët e zgjedhur.

Neni 8

Kryetari (KSI)

- 1- Kryetari i Këshillit Studentor Institucional (KSI) zgjidhet direkt kandidati më i votuar.
- 2- Kryetari i Këshillit Studentor Institucional drejton mbledhjet e këshillit, drejton diskutime dhe siguron zbatimin e rregullores.
- 3- Kryetari i Këshillit Studentor Institucional ka mandat 2 vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen dhe mandatimin e kryetarit të ri.
- 4- Kryetari i Këshillit Studentor Institucional drejton veprimtarinë e Këshillit Studentor.
- 5- Në veprimtarinë e tij shprehet me urdhëra.
- 6- Përfaqëson KSUSH në marrëdhënie me të tretët.
- 7- Përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillave Studentor.
- 8- Kujdeset për interesat e KSUSH dhe i mbro ato.
- 9- Bën deklarime publike për të shprehur qëndrimin zyrtar të KSUSH.
- 10- Deleton plotësisht ose pjesërisht kompetencat e tij tek zv/ kryetari.
- 11- Mban vulën e KSUSH.
- 12- Firmos dhe vulos hyrjen në fuqi të urdhërave dhe vendimeve.
- 13- Merr në shqyrtim propozime nga institucione, organizata dhe individë me qëllim bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë dhe i paraqet para këshillit.
- 14- Autorizon persona të ndryshëm të marrin pjesë në mbledhje me të drejtën e fjalës ose jo.
- 15- Kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra.
- 16- Shqyrton të gjitha çështjet financiare të KSUSH në funksion të transparencës.
- 17- Mban përgjegjësi për administrimin e financave.
- 18- Merr masa disiplinore për shkeljet e lehta dhe të mesme të disiplinës.
- 19- Propozon heqjen e mandatit të anëtarit para Këshillit Studentor Institucional.
- 20- Në raste të veçanta ndërmerr masa ndëshkimore deri në ndërprerjen e mandatit për shkelje të rregullores.

Neni 9

Zv/ Kryetari (KSI)

- 1- Zv/ Kryetari i Këshillit Studentor Institucional mund të jetë çdo anëtar i Këshillit Studentor Institucional.
- 2- Zv/ Kryetari i Këshillit Studentor Institucional zgjidhet me shumicë të thjeshtë me propozim nga anëtarët.
- 3- Kryetari i Këshillit Studentor Institucional i deleton plotësisht apo pjesërisht kompetencat e tij zv/ kryetarit.



Neni 10

Sekretari i Përgjithshëm (KSI)

- 1- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Studentor Institucional zgjidhet me shumicë të thjeshtë me propozim nga anëtarët.
- 2- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Studentor Institucional administrontë gjithë dokumentacionin e KSUSH.
- 3- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Studentor Institucional mban proces-verbalin e mbledhjes.

Neni 11

Mandatimi

- 1- Mandatimi i Kryetarit të Këshillit Studentor Institucional dhe Kryetarëve të Këshillave në nivel njësie qendrore kryhet nga Komisioni i Zgjedhjeve.
- 2- Mandatimi i zv/ kryetarit të KSI-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm të KSI-së kryhet nga Kryetari i KSI-së.

Neni 12

Mënyrat e Votimit

1- Mënyrat e votimit të KSUSH-së janë:

- a) Votim i hapur;
- b) Votim i fshehtë;


Votimi i hapur bëhet duke ngritur dorën.

Votimi i fshehtë bëhet në çdo rast kur e kërkojnë të paktën 2 anëtarë të Këshillit Studentor Institucional.

Neni 13

Zhvillimi i mbledhjeve

- 1- Mbledhjet e zakonshme të Këshillit Studentor Institucional zhvillohen çdo 2 javë.
- 2- Mbledhjet e zakonshme ndërmjet Këshillit Studentor Institucional dhe këshillave në nivel njësie qendrore zhvillohen çdo 4 javë.
- 3- Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren kur kërkohen me shkrim nga Kryetari i KSI-së në funksion të interesit të KSUSH ose nga të paktën 1/3 e anëtarësisë së Këshillit Studentor, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.






- 4- Mbledhja e organit kolegjal është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët me të drejtë vote, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.
- 5- Kryetari i KSI-së shqyrton dhe lajmëron datën dhe kohën e mbledhjes.
- 6- Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.
- 7- Në çdo mbledhje mbahet një proces-verbal, ku bëhet një përmbledhje e diskutimit në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve shoqëruar me arsyetimet përkatëse.
- 8- Proces-verbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit proces-verbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari.
- 9- Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, proces-verbali miratohet menjëherë pas përfundimit të mbledhjes nga organi i KSI-së.
- 10- Vendimet jonormative të organeve kolegjiiale hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar proces-verbali përkatës.
- 11- Anëtarët e organit kolegjal kanë të drejtë të kërkojnë që të shënohet në proces-verbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga ai organ.
- 12- Anëtarët e organit kolegjal, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.
- 13- Kryetari i organit kolegjal voton i fundit.
- 14- Organi kolegjal merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 14

Rendi i ditës

- 1- Kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.
- 2- Rendi i ditës duhet të përmbajë ato çështje që i janë propozuar Kryetarit nga anëtarët e organit kolegjal me të drejtë vote dhe që janë në kompetencë të këtij ligji.
- 3- Kërkesa për përfshirjen e një çështjeje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 5 ditë para datës së vendosur për mbledhjen,
- 4- Rendi i ditës duhet t'i paraqitet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.




Neni 15

Kuorumi

- 1- Mbledhja e organit kolegjal është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
- 2- Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së pares kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme nëse janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 16



Barazia e Votave

- 1- Vota e Kryetarit është vendimtare në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme. Në qoftë se edhe në votimin e parë të mbledhjes së ardhshme ka barazi të votave, atëherë do kryhet votim i hapur.

Neni 17



Shkeljet disiplinore

- 1- Veprime, ose sjellje, të cilat identifikohen si shkelje të lehta përfshijnë rastet në vijim:
 - a. Përsëritje të vonesave;
 - b. Mungesë e shkurtër e paautorizuar;
 - c. Email-a jo të përshtatshëm me kërcënime, fyerje, diskriminime;
 - d. Reagime negative ndaj instruksioneve, ose problemeve rutinë;
 - e. Mospranimi i detyrave të përditshme për t'i kryer në afat racional;
 - f. Akte të vogla të mosbashkëpunimit të qëllimshëm;
 - g. Akte dhe sjellje tjera joadekuate të nivelit të ngjashëm.
- 2- Veprime, ose sjellje, të cilat identifikohen si shkelje të mesme i përfshijnë rastet në vijim:
 - a. Raste të përsëritjes së shembujve më lart;
 - b. Sjellje e keqe që shkakton joefiçencë, ose probleme me rrjedhën e punës ose kolegët;
 - c. Inkurajimi i të tjerëve për mosrespektim të rregulloreve;
 - d. Akte dhe sjellje tjera joadekuate të nivelit të ngjashëm.



3- Veprime, ose sjellje, të cilat identifikohen si shkelje të rënda i përfshijnë rastet në vijim:

- a. Shkelje disiplinore të lehta, ose të mesme të përsëritura pas dy vërejtjeve me shkrim;
- b. Refuzimi, ose dështimi për të kryer ndonjë nga detyrat e përcaktuara;
- c. Vjedhja, mashtrimi, falsifikimi i informatave, ose dokumenteve;
- d. Ryshfeti dhe korrupsioni;
- e. Diskriminimi, ose keqtrajtimi direkt, ose indirekt i personit tjetër, mbi bazë gjinie, race, ngjyre, paaftësie, etnike, ose shoqërore-ekonomike, të rrethanave familjare, fesë, bindjeve politike, orientimit seksual ose të ndonjë dallimi tjetër të parëndësishëm;
- f. Ngacmim, ose mobing i çdo lloji që abuzon dinjitetin, ose reputacionin akademik, ose profesional të një personi tjetër;
- g. Sjellja agresive, frikësimet, ose vrazhdësitë dhe sjellje tjera të dhunshme;
- h. Sjellja e keqe në dhe jashtë vendit të detyrës që mund ta diskreditojë reputacionin e Universitetit;
- i. Dëmtimi i pasurisë me qëllim, apo përdorimi i paautorizuar i pajisjeve dhe pronës së Universitetit;
- j. Shkelja e konfidencialitetit;
- k. Dhënia e deklaratave të rreme për interes personal, ose me qëllim të shkakimit të konfliktit;
- l. Dështimi për të raportuar konfliktin e interesit;
- m. Paaftësitë gjatë orarit të detyrës që shkaktohen nga alkooli ose droga;
- n. Akte dhe sjellje tjera joadekuate të nivelit të ngjashëm.



Neni 18

Masat disiplinore

- 1- Për shkeljet e lehta disiplinore këshillim dhe më pas me vërejtje me gojë në rast të përsëritjes. Në rast të përsëritjes të vazhdueshme cilësohet si shkelje e mesme.
- 2- Për shkeljet e mesme disiplinore:
 - a. Vërejtje e parë me shkrim;
 - b. Vërejtje e dytë me shkrim.
 - c. Në rast përsëritjeje të vazhdueshme cilesohet si shkelje e rëndë.
- 3- Për shkeljet e rënda disiplinore:
 - a. Kryetari i KSI-së urdhëron pezullimin nga detyra për të paktën 4 javë.
 - b. Kryetari i KSI-së paraqet kërkesën për heqjen e mandatit para Këshillit Studentor Institucional. Kërkesa miratohet me shumicë të thjeshtë.

Neni 19



Shkarkimi i Kryetarit (KSI)

- 1- Kryetari i KSI-së shkarkohet për shkelje të rënda. Procedura për shkarkimin e tij i nënshtrohet periodikisht dy kuorumeve 30 ditë njeri pas tjetrit të cilat kërkojnë votim të hapur me të paktën 4 anëtarë të shprehur "Pro" shkarkimit.
- 2- Kërkesa i paraqitet Komisionit Institucional Të Zgjedhjeve Studentore për shqyrtim.
- 3- Komisioni Institucional i Zgjedhjeve Studentore vendos pezullimin e kërkesës ose heqjen e mandatit të kryetarit.

Neni 20

Shkarkimi i Zv/ Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm

Zv/ Kryetari i KSI-së dhe Sekretari i Përgjithshëm i KSI-së shkarkohen për shkelje të rënda apo të përsëritura të përcaktuara në nënin 17, me kërkesën e të paktën 4 anëtarëve të Këshillit Studentor Institucional.



Neni 21

Humbja e mandatit

Anëtari i Këshillit Studentor humb mandatin kur:

- 1- Kryen më shumë se 3 mungesa të pajustificuara në takimet periodike apo të jashtëzakonshme.
- 2- Shkarkohet.
- 3- Jep dorëheqjen.
- 4- Kryen shkelje të rëndë të disiplinës apo shkelje të përsëritua të rregullores.
- 5- Nuk zbaton vendimet e Këshillit Studentor Institucional dhe/ose Kryetarit.

III. Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 22

Ndryshimi i rregullores.

- 1- Kjo rregullore shqyrtohet për ndryshim me propozimin e të paktën 3 anëtarëve të KSI-së.
- 2- Ndryshimet mund të bëhen vetëm me vendimin e të paktën 4 anëtarëve "Pro" të KSI-së.

Neni 23

Për çdo detaj të paparashikuar në rregullore, në raste të jashtëzakonshme vendoset sipas udhëzimit të KSI-së.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore i paraqitet Këshillit Studentor dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Studentor Institucional.

Miratuar me datë 10 / 05 / 2022



KRYETARI

Armando LEKAJ



